



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 07.04.2015, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Taulant Balla - zëvendëskryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.03.2015.
2. Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Europian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”” .

Marrin pjesë:

Taulant Balla, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Esmeralda Shkjau, Gerti Bogdani, Sadri Abazi dhe Ilir Xhakolli.

Mungojnë:

Arben Imami, Majlinda Bregu, Edi Paloka dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Ilir Bejtja - zëvendësministër i Energjisë dhe Industrisë.

Miranda Lila - këshilltare e ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Entela Çipa - këshilltare e ministrit të Energjisë dhe Industrisë.

Agim Bregasi – drejtor i Politikave të Zhvillimit Elektroenergjetik, në MEI.

Enea Karakaci - përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit në MEI.

Erisa Xhixho - zëvendësministre e Integritimit.

Gentian Xhaxhiu - përgjegjës Sektori në MIE.

Rudina Lula – përgjegjëse Sektori në MIE.

Enkeda Korksi - përfaqësuese e Ministrisë së Financave.

Veronika Korkaj - përfaqësuese e Ministrisë së Financave.

HAPET MBLEDHJA

Taulant Balla - Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi iratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, të datës 30.3.2015.

Ju njoftoj se procesverbali ju është dërguar me *e-mail* dhe besoj se jeni të gjithë dakord me miratimin e tij.

Pika e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Pika e tretë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit European për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)” .

Për projektligjin e dytë janë të pranishëm përfaqësuesit e MEI-t përkatësisht: zoti Ilir Bejtja, zëvendësministër i Energjisë dhe Industrisë, Entela Çipa këshilltare e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Miranda Lila, këshilltare e ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Agim Bregasi, drejtor i Politikave të Zhvillimit Elektro-Energjetik, në MEI dhe zoti Enea Karakaci, përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit në MEI.

Fjala është për ju, zoti zëvendësministër!

Ju lutem, të na bëni një përshkrim të projekt-aktit, qëllimit dhe objektivave, që synohen të arrihen përmes kësaj nisme ligjore.

Ilir Bejtja – Përshëndetje!

Ju falënderoj për ftesën!

Meqë na janë paraqitur disa komente, lidhur me përkufizimet e ligjit, mos do të ishte më mirë të reflektonim fillimisht dhe më pas ta vazhdonim?

Taulant Balla – E para, në komision do të filloni me prezantimin e projektligjit dhe më pas, do të na thoni nëse ju duhet kohë për të reflektuar për propozimet që vijnë nga Njësia e Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit. Më tej, do të vazhdojmë me procedurën.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ndërkohë që ju bëni prezantimin, specialistët mund t'i shohin komentet.

Iliir Bejtja – Ky është ligji bazë që rregullon sektorin e energjisë elektrike dhe një nga aktet më të rëndësishme për funksionimin e këtij sektori. Ai rregullon marrëdhëniet midis operatorëve që veprojnë në këtë sektor, duke mundësuar krijimin e një tregu konkurrues, integrimin e tij në tregun rajonal, përmirësimin e sigurisë në furnizim dhe rritjen e cilësisë së furnizimit me energji elektrike për të gjithë konsumatorët fundorë në tregun vendas.

Projektligji përmbush angazhimet që Shqipëria ka marrë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, duke harmonizuar legjislacionin e këtij sektori me direktivat dhe rregulloret e BE-së, kryesisht, ato të paketës së tretë legjislative të sektorit të energjisë dhe ka marrë miratimin nga sekretariati, pasi janë reflektuar komentet që ata kanë sjellë në kohë.

Projektligji ka qëllim krijimin e kuadrit ligjor në këtë sektor, me objektiv krijimin dhe funksionimin konkurrues të tregut të energjisë elektrike, i cili do të mundësojë një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, duke marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve, minimizimin e kostos së shërbimit të furnizimit me energji elektrike, përshtatshmërinë e tij me mjedisin dhe interesat e gjeneruesve dhe operatorëve të tjerë në treg.

Projektligji është parakusht për reformat e ndërmarra në këtë sektor, të cilat janë në aplikim e sipër.

Me këtë projektligj synojmë një reformë të thellë në sektor, e cila jo vetëm do të zgjidhë problematikën e krijuar ndër vite ndërmjet operatorëve të ndryshëm në treg, por do të mundësojë edhe zhvillimin më të shpejtë dhe të sigurt drejt një tregu efektiv dhe të qëndrueshëm në këtë sektor jetik për ekonominë e vendit, mirëqenien e qytetarëve, përfshirë integrimin tij në tregun rajonal dhe atë europian.

Sektori i energjisë ka një rol vendimtar në zhvillimin ekonomik, pasi është i ndërlidhur ngushtësisht me politikat ekonomike, sociale dhe mjedisore në vend.

Ky sektor duhet të funksionojë në përputhje të plotë me parimet e një tregu të lirë, të liberalizuar, konkurrent, të aftë për të realizuar eficiencën dhe kthimin në një burim të ardhurash për buxhetin e shtetit.

Hartimi dhe miratimi i këtij ligji është parë me përparësi, duke pasur parasysh situatën e vështirë dhe komplekse të krijuar pas heqjes së licencës së kompanisë CEZ, për shoqërinë e shpërndarjes së energjisë elektrike. Eksperienca negative në privatizimin e shoqërisë së shpërndarjes së energjisë dhe riblerja e të gjitha aksioneve të shoqërisë CEZ nga ana e qeverisë

shqiptare, ka bërë të domosdoshëm ristrukturimin e të gjithë sektorit elektro-energjetik, përfshirë ndryshimin e modelit të tregut të energjisë elektrike.

Për të mundësuar një ristrukturim të këtij sektori dhe një dizejm të modelit të ri të tregut, duhet mbështetja ligjore, e cila realizohet nëpërmjet këtij ligji.

Efektet e këtij ligji do të jenë të menjëhershme në pikëpamjen e përcaktimit të qartë të funksioneve dhe përgjegjësisve të operatorëve të ndryshëm të sektorit të energjisë elektrike, përfshirë liberalizimin e mëtejshëm të tij dhe përmirësimin e efikasitetit të sektorit.

Në mënyrë specifike, ky projektligj parashikon:

Së pari, politikat e sektorit elektro-energjetik. Projektligji përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat e KM-së dhe të ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë, lidhur me hartimin e politikave dhe të strategjive të zhvillimit të sektorit elektro-energjetik, ku KM-ja është përgjegjës për politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit elektro-energjetik, ndërsa ministria është hartuese dhe propozuese e këtyre politikave, si dhe bën vlerësimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese dhe gjeneruese në vend.

Në mënyrë të qartë ndan politikëbërjen dhe përgjegjësitë rregullatore mes qeverisë dhe ERE-s, autorizon ministrin përgjegjës për Energjinë për të urdhëruar mbledhjen e të dhënave të konsumit të energjisë dhe furnizimit nga tregu, me qëllim të përdorimit të tyre për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare të Energjisë dhe dokumenteve të tjera të politikës së energjisë.

Projektligji kërkon një rregullator të fortë dhe plotësisht të pavarur, që do të ketë kompetenca të plota në rregullimin e energjisë elektrike, në veçanti, në dritën e liberalizimit të tregut të kësaj energjie.

Siguria e furnizimit është, gjithashtu, një element i marrë në konsideratë në ligj.

Si element shumë i rëndësishëm është parashikuar detyrimi i palëve për marrjen e masave për zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave për sigurimin e furnizimit me energji elektrike, që përfshin masat për sigurinë e furnizimit me energji, masat që ndërmerren në rastin kur rrezikohet siguria e furnizimit, masat që ndërmerren në rastet e situatave emergjente, rolin dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tregut në lidhje me sigurinë e furnizimit.

Këshilli i Ministrave, ERE, së bashku me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, do të marrin masa për ruajtjen e balancës midis kërkesës për energji elektrike dhe disponueshmërisë së kapacitetit prodhues në vend.

Në këtë ligj përcaktohet që Enti Rregullator i Energjisë është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit në Shqipëri, që ushtron aktivitetin në bazë të vendimeve të Bordit të Komisionerëve, që miratohen nga Kuvendi.

Në nenin 10 të këtij projektligji konfirmohet pavarësia ligjore dhe funksionale e këtij institucioni publik, që ushtron funksionet në mënyrë të paanshme dhe transparente. E theksoj fjalën “konfirmohet”, pasi kjo edhe më parë ka qenë e garantuar me ligj.

Në dispozitat vijuese përcaktohet mënyra e zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të bordit, shkarkimit dhe lirimit nga detyra dhe funksionin e kryetarit të bordit, që është administratori i Përgjithshëm i ERE-s.

Një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm i funksionimit të ERE-s sipas modelit më të mirë të BE-së është pavarësia financiare, e cila përcaktohet në nenin 17. Në kryerjen e aktivitetit të vet, ERE-ja miraton buxhetin, i cili përballohet nga pagesat rregullatore që paguhet prej të licencuarve. Pagesa duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore.

Sa i takon sistemit elektro-energjetik, ai ka disa elemente të rëndësishme: në themel të tij qëndron dispozita e përgjithshme e sistemit të energjisë dhe rregullat mbi rrjetin dhe interkoneksionin.

Në seksionin e dytë të kësaj pjese përcaktohen veprimtaritë e licencuara, të cilat përfshijnë prodhimin, operimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, furnizimin me energji elektrike, tregtimin dhe operimin e tregut të energjisë elektrike.

Në seksionin e tretë përcaktohen procedurat e autorizimit dhe tenderimit për kapacitetet e reja prodhuese, që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në seksionin katërt të kësaj pjese përcaktohen parimet e funksionimit të sistemit të transmetimit. Në këtë seksion përcaktohet një koncept i ri sa i përket caktimit të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit. ERE-ja miraton një procedurë të hollësishme për kërkesat për aplikim dhe certifikim të OSTEE-së, për të provuar pavarësinë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Në seksionin pestë të kësaj pjese, përcaktohen rregullat e shpërndarjes së energjisë elektrike, që kryhen nga operatorët e sistemit të shpërndarjes, të cilët janë persona juridikë të licencuar nga ERE.

Në seksionin gjashtë të kësaj pjese përcaktohen disa risi të këtij ligji, për sa i përket matjes së energjisë elektrike.

Element shumë i rëndësishëm është edhe garantimi i furnizimit të energjisë elektrike në cilësi dhe në kohë.

Këto janë pak a shumë elementet kryesore që sjell projektligji si për sa u përket garancisë, furnizimit, matjes, por edhe detyrimit për shlyerjen e faturës së energjisë elektrike nga konsumatorët.

Element i rëndësishëm i futur në këtë projektligj është mbrojtja e klientëve, konsumatorëve, si edhe aplikimi, zbatimi i direktivës për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike.

Në dispozitat e tjera janë përcaktuar qartë të drejtat e pronësisë mbi sistemin.

Hartimi i këtij projektligji nuk ka pasur shpenzime buxhetore dhe asistencë është financuar nga USAID-i.

Taulant Balla - Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Të dëgjojmë përfaqësuesit e Ministrisë së Integritimit.

Erisa Xhixho - Projektligji është në përputhje me angazhimet që rrjedhin nga neni 107 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, me rekomandimet e progresraportit të Komisionit Europian për 5 vjet me radhë nga viti 2010 deri në vitin 2014, si edhe me planin kombëtar të Integritimit 2014-2020.

Në vlerësimin tonë projektligji përfron pjesërisht direktivën 2009/72 gjë që vetë Ministria e Energjisë e ka reflektuar në relacionin që ka përcjellë në Kuvend. Janë përfruar disa nene të direktivës, ndërkohë që disa nene të tjera nuk janë përfruar.

Taulant Balla - Cili ka qenë shpjegimi nga ana e Ministrisë së Energjisë, se përse nuk janë përfruar?

Erisa Xhixho - E kanë zgjedhur vetë që të mos i përfronjë këto nene.

Taulant Balla - Po ju çfarë qëndrimi keni pasur për këtë çështje?

Erisa Xhixho - Nuk na e kanë sjellë *feedback*-un. Unë tani e konsultova përpara se të hyja në mbledhje. Kemi bërë disa komente në lidhje me nenet që ata kanë përfruar, si te përkufizimet dhe në nene të tjera specifike.

Taulant Balla – Të dëgjojmë përfaqësuesit e Njesisë së Përafrimit.

Dedë Kasneci - Njësia e Përafrimit e ka analizuar projektligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”. Në analizën tonë ligji është tërësisht i përputhshëm me legjislacionin përkatës të BE-së.

Në relacionin e paraqitur janë disa nene të veçanta ku thuhet se përputhja është e pjesshme, por ajo është në kohë, pra me kalimin e kohës ajo do të jetë në përputhje të plotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është në kohë, sepse ka parashikuar shprehimisht që përputhja do të bëhet me kohë e plotë.

Taulant Balla – Të dëgjojmë përfaqësuesin e ministrisë lidhur me çështjen e përafrimit.

Agim Bregasi - Në fakt qëllimi i këtij projektligji ka qenë të krijojë kuadrin ligjor me të cilin do të veprojë i gjithë sistemi elektroenergjetik në Shqipëri dhe në sajë të angazhimeve që kemi në kundërshtim BE-së, si në MSA, por edhe në Traktatin e Komitetit të Energjisë së paketës 3 të tregut të brendshëm, kemi bërë përputhje të plotë për situatën ku jemi.

Ajo që tha përfaqësuesja e Ministrisë së Integritetit është për dy- tri nene të veçanta, ku ka një spostim në kohë, sepse gjatë tri vjetëve kur ishte në administrim të CEZ- AS, shoqëria e shpërndarjes krijoi një pengesë, bllokim të reformave në sektorin e energjisë dhe ne nuk do të mundim të përafronim në këtë kuadër ligjor për momentin, që të jetë i aplikueshëm nga dita e miratimit të tij, por në bashkëpunim me Sekretariatit e Vjenës kemi përcaktuar afate dhe për ato tri afate kohore për të cilat nuk ka përputhje të plotë. Këto i kemi sqaruar në relacion. Shpjegimi është ky: kemi një spostim në kohë për tri afate për hapjen e tregut. Vetëm kjo është mospërputhje, të themi në kohë reale për sot që të hyjë në fuqi ligji dhe të veprojë, por në parashikimin që kemi bërë në projektligj në bashkëpunim me Sekretariatit e Vjenës është pranuar edhe nga ata dhe themi që projektligji është në përputhje të plotë me direktivat.

Ky projektligj ka lidhje me zbatimin e të gjitha reformave. Në parim i kemi të gjitha reformat të miratuara dhe do të fillojë zbatimi i tij.

Taulant Balla – Dakord.

Faleminderit!

Njësia e Përafrimit të Legjislacionit në relacionin që ka përgatitur ka bërë disa propozime.

Ju lutem, ju duhet t'i shikoni ato së bashku. Më pas në variantin e dakordësuar, të paraqiten në relacionin që do të bëjë Komisioni i Integritetit për t'ia paraqitur seancës plenare.

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Jemi dakord që projektligji të kalojë në seancë plenare.

Faleminderit, zoti zëvendësministër!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 07.04.2015, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Taulant Balla - zëvendëskryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”” .

Marrin pjesë:

Taulant Balla, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Esmeralda Shkjau, Gerti Bogdani, Sadri Abazi dhe Ilir Xhakolli.

Mungojnë:

Arben Imami, Majlinda Bregu, Edi Paloka dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Erisa Xhixho - zëvendësministre e Ministrisë së Integritimit

Taulant Balla - Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”” .

Siç jeni në dijeni me vendim të Kuvendit është vendosur që ky projektligj të kalojë me procedurë të përshpejtuar në seancën e datës 09.04.2015.

Zonja zëvendësministre e Integritit, ju lutem, na bëni një prezantim sa më të shkurtër, sepse relacionin e kemi.

Dua të informoj kolegët deputetë se për shkak të madhësisë së materialit, i cili është prej disa qindra faqesh, nuk është printuar, por e keni në *e-mail*. Kushdo që dëshiron të shikojë të gjithë projektligjin mund ta verifikojë.

Erisa Xhixho - Faleminderit!

Për sa i përket marrëveshjes kuadër, mund të them se pas periudhës 7 -vjeçare të zbatimit të asistencës financiare IPA të BE-së të vendit tonë, të miratuar nga Rregullorja e Komisionit nr.718 të datës 12 qershor 2007, Parlamenti Europian dhe Këshilli miratuan më 11 mars të vitit 2014 Rregulloren e BE-së nr.231 të vitit 2014 për krijimin e instrumentit të ri të asistencës së paraanëtarësimit apo Rregullores IPA 2. Ky instrument në vazhdim do të përbëjë bazën ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendin tonë për ta mbështetur atë në miratimin dhe në zbatimin e reformave politike institucionale ligjore, administrative, sociale, ekonomike, si edhe për të përafruar gradualisht rregullat, standardet dhe politikat e BE-së me synimin për t’u bërë vend anëtar.

Zbatimi i programit të asistencës financiare të Komisionit Europian në vendin tonë do të bëhet në bazë të rregullores zbatuese, ku përcaktohen dispozitat për menaxhimin dhe kontrollin e asistencës së BE-së. Më 11 mars të vitit 2014 Parlamenti Europian dhe Këshilli miratuan Rregulloren e BE-së apo rregulloren e përbashkët zbatuese.

Neni 8 i Rregullores IPA 2 kërkon që Komisioni Europian dhe përfituesi IPA 2 të lidhin marrëveshjen kuadër për zbatimin e asistencës, me qëllim që të bien dakord me rregullat, të cilat do të aplikohen për zbatimin e asistencës së BE-së, që BE-ja i akordon vendit në kuadër të IPA 2.

Asistenca për përfituesit IPA 2 jepet mbi bazën e dokumenteve strategjike kombëtare ose shumëvendëshe, si edhe prioriteteve të identifikuara në kuadrin e politikave të zgjerimit të

përcaktuara nga BE-ja, duke pasur parasysh komunikatën për strategjinë e zgjerimit dhe progresraportin, si edhe rezolutat përkatëse të Parlamentit Europian, por edhe sipas nevojave dhe kapaciteteve të përfituesit.

Ndër të tjera kjo marrëveshje parashikon edhe lidhjen e marrëveshjeve sektoriale, që nënkupton një marrëveshje që lidhet ndërmjet Komisionit dhe përfituesit IPA 2 për një fushë apo program specifik të IPA 2, ku përcaktohen rregullat dhe procedurat që duhet të respektohen, të cilat nuk përfshihen në këtë marrëveshje apo në marrëveshjet e financimit.

Një rëndësi e veçantë në këtë marrëveshje i është kushtuar pronësisë që vendi ynë duhet të tregojë për programimin dhe zbatimin e asistencës, duke qenë se ndryshe nga instrumenti IPA i mëparshëm pronësia do të jetë kryesisht e qeverisë shqiptare.

Për këtë qëllim koordinatori kombëtar IPA do të marrë një rol të veçantë në proces, duke shërbyer si strukturë homologe e Komisionit për të gjithë procesin e planifikimit strategjik, bashkërendimin e programimit, monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA 2.

Faleminderit!

Taulant Balla – Dakord. Duke qenë se ne jemi komisioni përgjegjës, dua t’ju informoj se Komisioni i Jashtëm nuk ka pasur komente, ndërsa Komisioni i Ligjeve ka bërë vetëm dy rekomandime.

Rekomandimi i parë është që në përkthimin në shqip fjala “asistencë” të zëvendësohet me fjalën “mbështetje”, pasi është më shqip.

Në preambulën e projektligjit të hiqet referenca me nenin 82, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës.

Këto duhet t’i shikoni edhe në relacionin fundor të komisionit tonë, me qëllim që të reflektohen.

Besoj se biem dakord edhe për fjalën “asistencë” që zëvendësohet me fjalën “mbështetje”. Pra, edhe në titullin e projektligjit të mos jetë fjala “asistencë”, por të jenë fjalët “në zbatim të mbështetjes financiare të BE-së”. I kanë rënë shkurt ata që kanë bërë përkthimin, por shqipja ka fjalë korrekte për këtë punë.

Të dashur kolegë dhe kolege, ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Jemi dakord që ratifikimi i marrëveshjes kuadër të kalojë në seancë plenare për të marrë miratimin përfundimtar të Kuvendit dhe për të hyrë në fuqi.

Faleminderit!

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA